



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:252564

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05131495

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.1122/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Leon Përlaska në çështjen penale kundër të pandehurit S. A. sipas aktakuzës me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të e detyrueshëm psikiatrik të Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2308/2023 të datës 13.12.2023 për shkak të veprës Sulm nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.12.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit S. A. dhe mbrojtësit të tij Av.Budak Shala si dhe në praninë e ekspertit psikiatër Dr. N. P., me datë 26.12.2023 shpalli ndërsa me datë 27.12.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. A., i lindur me, në Pejë, me vendbanim në fsh. V. rr. "H. H." rajoni K-Peje, i biri i Gj., dhe nënës S., e vajzërisë A., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike identifikuar me numër personal nr....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

I. Më dt. 11 dhe 12.11.2023 në fsh. V. K. Pejë, pikërisht në shtëpinë e tij, brenda marrëdhënies familjare, me dashje dhe në vazhdimësi, përdor forcën ndaj të dëmtuarës S. A.- të cilën e ka nënë,

në atë mënyrë që, më datë 11.11.2023, derisa i pandehuri dëshiron ta lëshoj lavatriqen dhe kur nëna i thot që aty nuk ka rrymë dhe nuk mund ta lëshosh, i pandehuri e kap me të dy duart për fyti, por pasi e njëjta e lut ta lëshoj, i pandehuri e lëshon, gjersa me datë 12.11.2023, rreth orës 14:00 pasi që e dëmtuara i drejtohet me fjalët “*djalë kishe bërë mirë që të shkosh te mjeku për të marrë terapinë*”, i njëjtë acarohet duke e sulmuar, e njëjta arrinë të largohet, të futet në dhomë dhe mbyll derën, i pandehuri duke e goditur disa here derën me shkelma, tenton të futet brenda, por nuk arrinë të futet brenda,

- Me çka në vazhdimësi ka kryer vepër penale sulm nga neni 184 par.1 lidhur me neni 77 të KPRK-së.

II. Me dt. 19.11.2023, rreth orës 13:35, në V. K. Pejë, në shtëpinë e tyre, brenda marrëdhënies familjare, i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës S. A.- të cilën e ka nënë, në atë mënyrë që, ditën kritike, derisa e dëmtuara ishte duke përgatitur ushqimin, i pandehuri fillimisht e gjuan të dëmtuarën me një kuti druri, e pastaj e godet me grushta në kokë dhe pjesë të tjera të trupit, ku e dëmtuara i ngritë duart duke qarë, i pandehuri duke e ngrit gishtin, i thotë “*as zërin mos ta ndi*”, me ç’rast e dëmtuara ka pësuar lëndime trupore,

- Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit S. A. i shqipton:

- I. Për veprën penale si në pikën I. të aktgjykimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- II. Për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Për veprën penale si në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënim unik, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Në dënimin e shqiptuar do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.11.2023 deri sa paraburgimi të jete në fuqi.
- V. Të dënuarit S. A. i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në institucionin e kujdesit shëndetësor, e cila masë do të pushohet nga gjykata pasi të këtë pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor, por nuk do të zgjas me shumë së tre vjet.
- VI. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik do të zbatohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Pejë, të cilët janë të obliguar ti raportojnë gjykatës në lidhje me mbarëvajtjen e masës.
- VII. I pandehuri lirohet nga obligimi i pagesës së shpenzimeve të procedurës dhe të njëjtat mbesin në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIM

A. Rrjedha e procedurës;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshme pranë kësaj gjykate ka paraqitur Aktakuzë me propozim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim me shenjë PP/II.nr.2308/2023 të datës 13.12.2023 kundër të pandehurit S. A. për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.12.2023 në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri S. A. me mbrojtësin Av.Budak Shala si dhe eksperti psikiatër Dr.N. P.dhe mbrojtësja e viktimave Arta Xhevuka.

Fillimisht gjykata e mori mendimi e ekspertit psikiatër ne lidhje me faktin se i pandehuri a është ne gjendje ta përballoj gjykimin, ta kuptoj akuzën dhe te konsultohet me mbrojtësin e tij, ne te cilat pyetje u përgjigj eksperti psikiatër duke konstatuar se i pandehuri ka mundësi ta ndjek gjykimin dhe te kuptoj veprimet e veta procedurale.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri S. A. deklaroi se e pranon fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë, ku pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit në kuptim të nenin 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Pastaj duke zbatuar nenin 513 të KPPRK-së gjykatë në seancë të shqyrtimit gjyqësor e dëgjoj ekspertin psikiatër Dr.N. P., i cili i dha shpjegimet e tij si në vijim:

“ Duke kuptuar se i njëjti vuan nga çrregullimi mendore F32 siç është depresion dhe se ne këtë gjendje e ka ne kohe te gjate me trajtime te here pas hershem , si dhe me përdorim te terapisë jo te rregullt, kjo gjendje ne momentin kritik die te përkeqësohet me çrrastë vetëdija e tijë për ti kuptuar veprimet e veta zvogëlohet ne mase esenciale , si dhe i njëjti nuk mund ete kontrolloj veprimet ose mos veprimet e tijë , krejt kjo si rezultatat i këtij çrregullimi qe ky e manifestonë. Çrregullimet e tilla ne te shumtën e rasteve kryhen ne forme ambulatorike , përpos ndonjëherë kur është ne fazën akute te vete lëndimit, tentament –sfiucidi, atëherë kjo faze trajtohet ne spital, duke u bazuar ne gjendjen e tijë momentale kemi qene te mendimit si ekip uneanimisht qe i njëjti trajtimin psikiatrik ta vazhdoj ne liri , ne tretman ambulatoriki , e ne raste te përkeqësimit ne e pranojmë te njëjtin ne spital dhe e trajtojmë aty”.

Prokurori i shtetit në lidhje me masën dhe dënimin deklaroi: “Duke mare parasysh se këtu i akuzuari e pranoj fajësinë Konform kushteve ligjore te parapara me neni 242 te KPPRK-se , ngase pranimin e fajësisë e bere duke i kuptuar ne tërësi pasojat dhe benefitet e pranimi te fajësisë, pranimin e fajësisë e bere ne mënyre vullnetare, dhe ne mbështetje ne faktet qe përmban aktakuza , andaj nga gjykata kërkoj qe te akuzuarin ta shpallë fajtorë ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj ne paguarjen e shpenzimeve te procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimi te llojit dhe lartësisë se dënimit , pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethen lehtësuese , ndërsa ne kuptim te diospozitave ligjore te nenit 70 par.2 pika 2.13 dhe 2.14 te KPRK-se si rrethanë renduese te vlerësoj faktin se nga informacionet e personit lidhur me te kaluarën e tijë kriminale

konsiston se i akuzuari edhet i dyshuar edhe për dy vepra të tjera penale dhunës në familje dhe dy vepra penale të lëndimit të lehtë trupore, si dhe faktit se vepra penale e cila i vihet në bare është kryer në kuadër të marrëdhënies familjare. Sa i përket propozimit të trajtimit të detyrueshëm në liri mbesim pranë këtij propozimi ”.

Përfaqësuesja nga Zyra për mbrojtjen e viktimave deklaroi “E mbështes në tërësi deklarin e prokurorit të shteti po ashtu bazuar në neni 352 të KPPRK-se sa i përket ndikimit të veprës penale, kjo vepër ka ndiku negativisht të pala e dëmtuar si në aspektin emotiv ashtu edhe në aspektin psikofizik. Meqenëse pala e dëmtuar nuk është e prezentë sot , në emër të sajë kërkojmë dëmshpërblim”.

Mbrojtësi i të pandehurit S. A., në lidhje me masën dhe dënimin deklaroi: “Sa i për ketë propozimit për shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm në liri nuk e kundërshtojmë , ngase kjo është edhe në interes të të pandehurit duke u lidhur në faktin se ashtu siç e sqaroi psikiatri që në momentin e kryerjes dhe në rastet e ndryshme , diagnoza nga e cila vuan i pandehuri mund të ketë edhe kriza , e që në rastin e tanishëm, i njëjti është në gjendje shumë më të mirë , e kjo si rezultat i marrjes së rregullt të terapisë dhe të cilën e ka premtuar se do të vazhdojë , ndërsa sa i përket lartësisë së dënimit propozoj që të merren si rrethana lehtësuese, pranimi i fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, e njëkohësisht propozoj që pas marrjes së vendimit të njëjtit të ndërkrehet masa e paraburgimit , e cila nuk është edhe në kundërshtim edhe me propozimin e prokurorisë , përkatësisht trajtimin e detyrueshëm në liri.

I pandehuri S. A. deklaroi se “ Pajtohem me deklarin e mbrojtësit tim, kam marrur trajtim gjatë qëndrimit në paraburgim dhe ndjej keqardhje për këtë rast që ka ndodhur ”.

B. Vlerësimi i gjykatës;

Gjykata kur vendosi në lidhje me vendimin për dënimin u bazua në dispozita ligjore përkatës, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, rrethanat lehtësuese dhe renduese dhe karakteristikat individuale të kryerësit.

Të pandehurit gjykata i shqiptoj për veprën penale si në pikën I. të aktgjykimit DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet

pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, pastaj në kuptim të nenin 76 të KPRK-së për veprën penale si në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptoi dënim unik, DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ku në dënimin e shqiptuar do të llogaritët edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.11.2023 deri sa paraburgimi të jete ne fuqi.

Për të shqiptuar këtë dënim gjykata mori parasysh fillimisht dënimin e paraparë për veprat penale, përkatësisht minimumin dhe maksimumin e dënimit, pastaj duke pasur parasysh udhëzuesin për politike ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të rastit dhe erdhi në përfundim për shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat lehtësuese dhe renduese:

Gjykata i analizoj me vëmendje rrethanat relevante renduese dhe lehtësuese të cilat edhe ndikuan në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit ku pas analizimit të çështjes dhe fakteve të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata si rrethanë renduese gjeti faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, faktin se viktimë është e moshës së vjetër si dhe faktin se viktimë e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata gjeti, pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, rrethanën e cila për pak nuk arrin të jetë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale që në këtë rast është aftësia e zvogëluar mendore e kryerësit dhe keqardhja e shfaqur nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar.

Vlerësimi i rrethanave renduese:

Fakti se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, përkatësisht se i pandehuri dhe viktimë e dhunës së ushtruar përmes veprës penale janë në relacion nënë dhe djalë, e megjithatë ky fakt nuk e ka penguar fare të pandehurin që ndaj viktimës të ushtroj dhunë sistematike për disa herë me radhë, gjithashtu kjo shpërfaq në masë të madhe nivelin e rrezikshmërisë që i kanoste në vazhdimësi këtu të dëmtuarës, kur merret parasysh fakti se e njëjta jeton në një kulm me këtu kryerësin e veprës penale, që është indikacion se nëse këtu i pandehuri nuk e merr dënimin e merituar i njëjti do të mund të përsëriste veprimet e njëjta ndaj të dëmtuarës, sepse siç

shihet nga vete dispozitivët e aktakuzës i njëjti i ka përsëritur këto veprime ne disa data të ndryshme.

Gjithashtu si rrethana renduese na paraqiten edhe mosha e vjetër e këtu te dëmtuarës dhe fakti se duke qene ne këtë moshe e bene qe te jete viktime posaçërisht e pambrojtur dhe e ndjeshme kur merret parasysh fakti se kryerësi i veprës penale është i ri dhe fizikisht i zhvilluar, qe paraqet disproporcion te madh në zhvillim, gjë e cila me rastin e ushtrimit të veprimeve të dhunshëm paraqet nivel me te lartë të rrezikut për viktimën e dhunës, qe ne ketë rast është grua dhe e moshuar.

Vlerësimi i rrethanave lehtësuese :

Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në fillim të seancës së shqyrtimit fillestar, ku në mënyrë deklarative me pranimin e fajësisë i pandehuri shprehi keqardhje dhe kërkim falje për të dëmtuarit, është tregues i fort i pendimit te të pandehurit dhe gatishmërisë së tij për të pranuar përgjegjësinë shoqërore për veprën e kryer.

Rrethanë tjetër është aftësia e zvogëluar e të pandehurit deri në shkallë esenciale, e cila për pak nuk arrin të jetë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale. Kjo rrethanë është tregues se i pandehuri veprën penale nuk e ka kryer në një shkallë të lartë të dashjes dhe se marrja e vendimit për kryerjen e veprës penale si njëra nga fazat e kryerjes se veprës penale është ndikuar nga çrregullimi psikik i të pandehurit. Ky konstatim i gjykatës mbështetet në raportin e ekzaminimit psikiatrik te të pandehurit S. A. të punuar nga grupi i eksperteve psikiatër dhe nga vet shtjellimi i ekspertizës së bërë nga Dr.N. P. në seancën e shqyrtimit fillestar, qe konfirmon se i pandehuri vuan nga Çrregullimi Mendor F 32.

Tjetër rrethanë lehtësuese është keqardhja e shfaqur nga i pandehuri, në seancën e shqyrtimit fillestar, mirëpo kjo keqardhje e shprehur nga e pandehuri, për gjykatën nuk ishte shumë bindëse e as e plotë, pasi qe i pandehuri ne mënyre formale, sipërfaqësore gati sa përçmuese e deklaroi këtë keqardhje.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat renduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe te gjitha së bashku , raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se rrethanat renduese i

mbi peshojnë ato lehtësuese e si rrjedhojë dënimi i shqiptuar të pandehurit S. A. është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik:

Prokuroria Themelore në Pejë ndaj të pandehurit S. A. ka paraqitur aktakuzë me propozim për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, këtë kërkesë prokuroria e ka mbështetur në raportin e ekspertizës psikiatriketë përpiluar nga grupi i ekspertëve Dr. N. P., Psikolog V. M. dhe Dr.M.H., të cilët nga ekzaminimi i drejtpërdrejtë i të pandehurit kanë konstatuar se i njëjti vuan nga çrregullimi mendor F32, ku edhe kanë rekomanduar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor e dëgjoj ekspertin psikiatër Dr.N. P., i cili konfirmoj konstatimet e dhëna si në raportin me shkrim duke u shprehur se “Duke kuptuar se i njëjti vuan nga çrregullimi mendor F32 siç është depresion dhe se në këtë gjendje e ka në kohe të gjate me trajtime të herë pas herëshëm si dhe me përdorim të terapisë jo të rregullt, kjo gjendje në momentin kritik dihe të përkeqësohet me ç’rastë vetëdija e tij për të kuptuar veprimet e veta zvogëlohet në mase esenciale , si dhe i njëjti nuk mund të kontrollojë veprimet ose mos veprimet e tij , kështu si rezultat i kësaj çrregullimi që ky e manifeston. Trajtimi për çrregullimet e tilla në të shumtën e rasteve kryhen në formë ambulatorike , përpos ndonjëherë kur është në fazën akute të vetë lëndimit, tentament –suiucidi, atëherë kjo fazë trajtohet në spital, duke u bazuar në gjendjen e tij momentale kemi qenë të mendimit si ekip unanimisht që i njëjti trajtimin psikiatrik ta vazhdojë në liri , në tretman ambulatorik , e në raste të përkeqësimit në e pranojmë të njëjtin në spital dhe e trajtojmë aty”.

Gjykata duke u bazuar në raportin e eksperteve psikiatër, dëgjimin e ekspertit në seancë si dhe në bazë të nenit 83, 84, dhe 86 par.1, 2 dhe 4 të KPRK-së dhe nenit 514 të KPPRK-së, ndaj të pandehurit S. A. shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, e cila masë do të pushohet nga gjykata pasi të këtë pushuar nevoja për trajtim, por nuk do të zgjas më shumë se tre vjet.

Gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin S. A. janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore siç parashihen në nenin 86 par.1 pikat 1.1 -1.3 të KPRK-së.

Vlerësimi i gjykatës për kohëzgjatjen e trajtimit përkatësish për pushimin e masës do të përcaktohet në bazë të raporteve mjekësore të nxjerra nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilat raporte konstatojnë pushimin eventual të nevojës për trajtim të mëtutjeshëm.

Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike;

Në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par.4 ku thuhet se “Në vendimin me të cilin vendoset për shpenzimet, gjykata mund ta lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompensimit, në tërësi ose pjesërisht, të shpenzimeve të procedurës penale nga neni 449, paragrafit 2, nën-paragrafët 2.1 deri në 2.6, dhe nën-paragrafit 2.9 të këtij Kodi, nëse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t’i mbështesë materialisht. Kur këto rrethana konstatohen pas marrjes së vendimit lidhur me shpenzimet, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me aktvendim të posaçëm mund të lirojë të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ose t’i lejojë që ato t’i paguajë me këste”, pasi që i pandehuri S. A. është i pa punë dhe me problemë shëndetësore të përshkruara si më lart, andaj çfarëdo ngarkesë për shpenzime të procedurës do të vështirësonte ekzistencën e të pandehurit.

Andaj, duke u bazuara në të lartcekurat si dhe në kuptim të nenit 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1122/23, dt.27.12.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnja

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.